



Planuar / Dorezuar Primijsen/Prodato Received/Delivery	17-11-2022	viti god year	2
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSTOK	7204/2022		115



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.849/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Jeton Koca dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.849/2022 të datës 03.10.2022 të parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_ më adresë banimi në \_\_\_\_\_

kundër organit të punësimit Komunës së Podujevës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 17.11.2022, mori këtë:

### V E N D I M

- I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa me numër A.nr.849/2022 e datës 03.10.2022 e parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_ ashtu që *aprovohet* pretendimi lidhur me listën e pritjes me numër reference 13-181/22 të datës 04.07.2022 sipas Konkursit me numër referencë RN00008678 të shpallur nga Komuna e Podujevës me datë 23.03.2022, për grup të pozitive "Specialist i Administrimit të Përgjithshëm-Zyrtar për Kadastër dhe Gjeodezi 4-klasa profesional 3", ndërsa, *refuzohet* pretendimi që ankuesi të përzgjidhet si kandidat fitues bazuar në listën e pritjes të datës 04.07.2022.
- II. **Anulohet** Akt-Njoftimi me numër 13-387/2022 i datës 27.09.2022 i Menaxherit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Podujevës, lidhur me kandidatin e suksesshëm sipas Konkursit me numër reference RN00009518 të shpallur nga Komuna e Podujevës me datë 22.07.2022.
- III. **Obligohet** Njësia e Burimeve Njerëzore në Komunën e Podujevës që brenda afatit pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi dhe në pajtim me dispozitat ligjore të bëj emërimin e kandidatit fitues për grup të pozitive "Specialist i Administrimit të Përgjithshëm-Zyrtar për Kadastër dhe Gjeodezi 4 -klasa profesional 3", pas renditjes së kandidateve fitues sipas listës së pritjes të datës 04.07.2022 dhe listës së datës 23.09.2022.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra.

#### A r s y e t i m

Ankuesi [redacted] kandidat për shërbim civil, më datë 03.10.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 5824/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër njoftimit të datës 27.09.2022 të Njesisë së Burimeve Njerëzore pranë Komunës së Podujevës lidhur me shpalljen e kandidatit fitues për pozitën Specialist i Administrimit të Përgjithshëm-Zyrtar për Gjeodezi dhe Kadastër, me pretendimin ankimor së Komuna e Podujevës ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 06.10.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Podujevës. Ndërsa Këshilli, me datë 07.10.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova:* Ankesën me numër të protokollit 5824/2022 të datës 03.10.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Konkursin me numër reference: RN00008678 të datës 23.03.2022 për grupin Specialist i Administrimit të Përgjithshëm; Njoftimin e verifikimit paraprak të datës 05.05.2022; Njoftimin e datës 11.05.2022 listën e kandidateve të ftuar për test me shkrim; Njoftimin e datës 17.06.2022 listën e ngushtë të kandidatëve për testin elektronik; Njoftimin e datës 01.07.2022 listën e kandidatëve të ftuar për intervistë me gojë; Njoftimin e listës përfundimtare të kandidatëve fitues nga Komisioni i Pranimit; Njoftimin e datës 07.07.2022 për shpalljen e kandidatit më i suksesshëm nga Komisioni i Pranimit; Rezultatet e vlerësimit të datës 04.07.2022; Konkursi i datës 22.07.2022 me numër reference: RN00009518 për grupin Specialist i Administrimit të Përgjithshëm; Kërkesa me numër protokollit 13-110/02-0079671/22 e datës 14.09.2022; Ankesa e datës 12.09.2022 e ushtruar nga ankuesi; Letërnjoftimi i ankuesit; E-mail i datës 03.10.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 06.10.2022; Përgjigjen në ankesë e 07.10.2022; Renditja Përfundimtareve e Kandidateve me numër reference:RN00008678 dhe Njoftimin e kandidateve të verifikimit paraprak të datës 08.09.2022 me numër reference: RN00009518; Njoftimin lidhur me rezultatet pas afatit të ankesës i datës 27.09.2022 me Nr. 13-387/2022, Konkursin lëvizje brenda kategorisë RN00009133, Njoftimin nr.13-166/2022 të datës 21.06.2022; lista e rezultateve të vlerësimit me nr.13-111/01-0082560/22 e datës 23.09.2022 sipas SIMBNJ, lista e rezultateve të vlerësimit me nr.13-181/22 e datës 04.07.2022 sipas nga SIMBNJ.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha provat së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi se ankesa e ankuesit është e pjesërisht e bazuar, **SEPSE:**

Nga administrimi i provave materiale rrjedhë së Komuna e Podujevës më datë 23.03.2022 ka shpallur Konkursin për pranim me numër reference RN00008678 për grup të pozitive "Specialit i Administrimit të Përgjithshëm-Zyrtar për Kadastër dhe Gjeodezi 4, klasa profesionale 3", e në të



cilin konkurs kishte aplikuar edhe ankuesi, ku i njëjti është përfshirë në të gjitha fazat e vlerësimit, ndërsa sipas Njoftimit me numra reference 13-181/22 të datës 04.07.2022 për shpallje të rezultateve përfundimtare të vlerësimit, ankuesi është renditur si kandidati i dytë fitues me gjithsej 70.4 pikë.

Me tej nga shkresat e lëndës, Kolegji gjen së Komuna e Podujevës pas shterimit të procedurës së lëvizje brenda kategorisë së njëjtë, serish më datë 22.07.2022 ka shpallur Konkursin për pranim me numër reference RN00009518 për grup pozitash "Specialist i Administrimit të Përgjithshëm-Zyrtar për Kadastër dhe Gjeodezi 4, klasa profesional 3", e në të cilën konkurs ankuesi kishte konkurruar por që i njëjti nuk i është nënshtruar fazave të tjera të vlerësimit. Komuna e Podujevës pas përfundimit të procedurës së vlerësimit me Njoftimin me numër reference 13-3111/01-0082560/22 të datës 23.09.2022 ka shpallur listën e kandidatëve fitues lidhur me Konkursin me numër reference RN00009518.

Ankuesi më datë 12.09.2022 i është drejtuar me kërkesë Udhëheqësit të Personelit të Komunës së Podujevës, se meqenëse ankuesi ka qenë në listën e pritjes sipas Konkursit të datës 23.03.2022, është dashur të aplikohet dispozitat e nenit 35 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe nenit 26 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimit Civil të Kosovës, përkatësisht të informohet ankuesi me rastin e hapjes së pozitës dhe ti jepet e drejta e përzgjedhjes në pozicione të lira.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon së Komuna e Podujevës ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil, duke shtuar së Komuna e Podujevës nuk ka marrë parasysh listën e pritjes së datës 04.07.2022 sipas Konkursit të datës 22.07.2022 me numër reference RN00009548 për pozitën e njëjtë Specialist i Administrimit të Përgjithshëm por Komuna e Podujevës serish për pozitën e njëjtë me datë 22.07.2022 ka shpallur Konkursin për pranim me numër reference RN00009518, ndërsa Njësia përgjegjëse nuk ka njoftuar ankuesin brenda shtatë (7) ditësh nga shpallja e listës fituese përkatësisht shfaqjes së pozitës së lirë dhe nuk ka përzgjedhur ankuesin në pozitën e lirë. Kërkon që Këshilli ta aprovoj ankesën, të anuloj Konkursin me numër referencë RN00009518 dhe të obligoj organin kompetent që me ankuesin të lidh kontratë punë në pajtim më dispozita ligjore.

Në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit i'u referua dispozitave ligjore në fuqi përkitazi me pranimin në shërbim civil përkatësisht:

Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, neni 34 përcakton se: "1. Përveçse kur parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë ligj, pranimi në Shërbimin Civil bëhet në kategorinë profesionale në grupin e administrimit të përgjithshëm dhe në secilin nga grupet e administrimit të veçantë. 2. Pranimi në kategorinë profesionale bëhet nëpërmjet një konkurrimi të hapur dhe publik. Konkurrimi organizohet në mënyrë periodike dhe sipas nevojave dhe së paku një herë në vit, për grupin e administrimit të përgjithshëm dhe për secilin nga grupet e administrimit të veçantë... 11. Në përfundim të vlerësimit, kandidatët e vlerësuar me 70 për qind apo më shumë, të pikëve totale të vlerësimit, konsiderohen kandidatë fitues dhe renditen nga Komisioni i pranimin, sipas pikëve të marra, në listën e kandidatëve të suksesshëm (në vazhdim: Lista e kandidatëve), e cila publikohet në ueb faqe...". Neni 35 përcakton se: "1. Kandidatët fitues, të përcaktuar sipas paragrafit 9 të nenit 34 të këtij ligji, sipas renditjes, duke filluar nga ai me më shumë pikë, kanë të drejtën të përzgjedhin dhe të emërohen

në çdo pozitë të lirë të grupit, për të cilin është zhvilluar procedura e pranimit, si dhe në çdo pozitë tjetër të lirë të të njëjtit grup, që krijohet i lirë gjatë kohës së vlefshmërisë së listës. 2. Njësia e përgjegjëse, brenda 7 ditëve nga shpallja e listës apo nga shfaqja e një pozitë të lirë, organizon procesin e përzgjedhjes të pozitës sipas preferencës nga kandidatët dhe bën emërimin e kandidatit në pozitën e përzgjedhur, sipas paragrafit 1 të këtij neni. Kandidati që ka zgjedhur një pozitë dhe është emëruar në të nuk mund të riuhtrojë të drejtën e përzgjedhjes. 4. Çdo emërim në kundërshtim me këtë nen është i pavlefshëm. 5. Lista e kandidatëve të paemëruar sipas paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni, është e vlefshme për një periudhë 1 (një) vjeçare nga shpallja e fituesve. Nëse gjatë kësaj periudhë organizohet një procedure tjetër konkurrimi për të njëjtin grup, kandidatët e listës së mëparshme rirenditen sipas rezultatit të të dyja listave. 6. Qeveria, me propozimin e ministrisë përgjegjëse për administratë publike, me akt nënligjor, miraton procedurat e hollësishme për emërimin në kategorinë profesionale”.

Rregullorja (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil, neni 25 ka paraparë se: “ 1.Kandidati fitues, sipas renditjes, duke filluar nga ai me më shumë pikë, njoftohet nga njësia përgjegjëse për pozitën e lira dhe ka të drejtën të përzgjedhë çdo pozitë të lirë të Grupit dhe të emërohet në të, për të cilin është zhvilluar procedura e pranimit, si dhe në çdo pozitë tjetër të lirë të të njëjtit Grup, që krijohet e lirë deri në një (1) vit nga shpallja publike e listës të kandidateve fitues. 2.Kandidati që ka përzgjedhur një pozitë dhe është emëruar në të, nuk mund të ushtrojë për herë të dytë, të drejtën e përzgjedhjes sipas paragrafit 1 të këtij neni. 3.Njësia e përgjegjëse, brenda shtatë (7) ditëve nga shpallja e listës apo nga shfaqja e një pozitë të lirë të Grupit përkatës, fton kandidatët fitues, sipas renditjes së tyre, të zgjedhin nga lista e pozicioneve të lira. Pëlqimi i kandidatit për të përzgjedhur një vend pune jepet me shkrim... 7.Lista e kandidatëve fitues që nuk janë emëruar, është e vlefshme për një periudhë 1 (një) vjeçare nga shpallja e listës të kandidatëve fitues. Nëse gjatë kësaj periudhë organizohet një procedurë tjetër konkurrimi për të njëjtin Grup, kandidatët e listës së mëparshme rirenditen sipas rezultatit të të dyja listave. 8.Lista e kandidatëve të emëruar dhe lista e kandidatëve të paemëruar mbahen publike sipas nenit 9 të kësaj Rregulloreje.

Rregullorja (QRK). Nr.26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, Neni 33 ka theksuar se: Klasat përbërëse të kategorisë Profesionale, dhe emërtesat e lejuara për secilën klasë janë: Profesional 1-Zyrtar i lartë; Profesional 2 - Zyrtar i mesëm; Profesional 3 -Zyrtar, Profesional 4-Zyrtar Administrativ; Shtojcën Nr.1/10: Përshkrimi i përgjithshëm i punës për klasën Profesional 3 si kërkesa të përgjithshme Formale janë përcaktuar: a) Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve universitare me të paktën 180 kredi/ECTS apo ekuivalente me to. b) Kualifikime të posaçme formale: Certifikata, Licenca kur kërkohen me legjislacionin në fuqi apo kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitën e kësaj klase. c) Përvoja e punës e kërkuar: nuk kërkohet; si dhe Shtojcën Nr. 2 sipas të cilës për Gr. Specialistë të Administrimit të Përgjithshëm kod nr. 58, si fusha të arsimit janë përcaktuar Arsim i lartë i paspecifikuar.

Rrjedhimisht, në kuptim të dispozitave ligjore si më sipër dhe duke u bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji ka konstatuar se në rastin konkret organi i punësimit përkatësisht Komuna e Podujevës nuk ka zbatuar drejt dispozitat materiale, ngase lista e kandidateve fitues (lista e pritjes) me numër reference 13-181/22 e datës 04.07.2022 për grupin e pozitave “Specialit i Administrimit të Përgjithshëm-Zyrtar për Kadastër dhe Gjeodezi”, ka qenë ende e vlefshme, kështu që me përfundimin e procedurës konkurruese me numër referencë RN00009518 për pozitë të njëjtë dhe të të njëjti grup, kandidatët fitues të të dy listave gjegjësisht të listës pritëse të datës 04.07.2022 si dhe listës së datës 23.09.2022 duhej të renditeshin në një listë bazuar në rezultatet e të dy listave dhe

përshtatshmërisht të aplikohej neni 35 paragrafi 1 i Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, andaj, mbi këtë bazë pretendimi ankimor se nuk është marr parasysh lista e pritjes e datës 04.07.2022 është i drejt dhe i bazuar ligjërisht.

Kolegji nga administrimi i shkresave të lëndës vlerëson së nuk qëndron pretendimi ankimor i ankuesit se me shfaqjen e pozitës së lirë për grupin " Specialist i Administrimit të Përgjithshëm-Zyrtar për Kadastër dhe Gjeodezi", Njësia Përgjegjëse brenda shtatë ditësh duhej të ftonte ankuesin për përzgjedhje në pozitën e lirë, ngase siç u konstatua me sipër, kandidatët e dy listave fituese duhet të renditen sipas rezultateve të pikave të vlerësimit të të dy listave dhe mbi bazën e pikëve të vlerësimit bëhet edhe përzgjedhja gjegjësisht emërimi i kandidatit fitues.

Andaj, nisur nga konstatimet si me lart, obligohet Njësia e Burimeve Njerëzore në Komunën e Podujevës që të ndërmer të gjitha veprimet e nevojshme ligjore-administrative për zbatimin e këtij vendimi siç përcaktohet në pikën III të diapozitivit të këtij vendimi.

Duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi që ankesa të aprovohet pjesërisht si e bazuar.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

#### **Këshillë juridike:**

*Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

### **KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS** Lënda me numër A.nr.849/2022

**Ilire Mehmeti SHAQIRI**

*[Signature]*  
Zyrtarë e Lartë për Bashkëpunim Profesional

**Ardita Haxhnikaj-DEMI**

*[Signature]*  
Kryetare e Kolegjit

#### **Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Podujevës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Podujevës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.